

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.K., nga fshati ..., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokuroria Themelore në Gjakovë Departamenti i Përgjithshëm të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Rahovec, P.nr.127/2016, datë 20.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 25.02.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Rahovec, P.nr. 127/2016, datë 20.08.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë – dega në Rahovec, me aktgjykimin P.nr.127/2016, datë 19.09.2018, të akuzuarin L.K., nga fshati ..., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, e ka liruar nga akuza, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, për shkak se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me anë të aktakuzës. Shpenzimet e procedurës kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor apo të njëjtin ta anuloj dhe çështjen penale ta kthej në rigjykim ose rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.88/2019, datë 28.01.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të shtetit, ashtu që i akuzuari të shpallet fajtor ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

## **Ankesa e prokurorit të shtetit, nuk është e bazuar**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e shkallës së parë me pretendimin se nuk e ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike duke e liruar të akuzuarin nga akuza, duke konstatuar se nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, sepse gjykata e shkallës së parë në rastin konkret gjatë procedurës së provave nuk i ka shqyrtuar të gjitha faktet vendimtare si dhe provat të cilat i ka pasur në dispozicion gjatë shqyrtimit gjyqësor gabimisht i ka vlerësuar këto prova duke nxjerr përfundim të gabuar. Prokurori konsideron se Gjykata e shkalles së parë me rastin e marrjes së aktgjykitimit lirues ndaj të akuzuarit ka cekur se nuk i ka falur besimin deklaratës së të dëmtuarit për arsyen se është i dëmtuar dhe tenton që të inkriminoj sa më shumë të dëmtuarin, se është kontradiktor me vetveten, se nuk ka sqaruar se nga kush i ka marr vendimet , nga i akuzuari apo djali i tij i mitur po ashtu nuk ja ka falur besimin deklaratës së dëshmitarit A.D. i cili ka qenë në vendin e ngjarjes, me arsyetimin se ai është shok i të dëmtuarit dhe ka qenë kontradiktor në deklaratën e tij , duke shtuar se Prokuroria nuk ka arritur ta argumentoj se cilat dëmtime ja ka shkaktuar të dëmtuarit i akuzuari dhe cilat dëmtime i mituri A.K.1., të cilit i është shqiptuar masa e diversitetit për të njëjtën çështje. Gjykata gjatë administrimit të provave sikurse ka cekur edhe në arsyetimin e aktgjykitimit duke vërtetuar se nuk është kontestuese se i dëmtuari nuk ka pësuar dëmtime kritike, andaj konsideron se gjykata është dashur të ia fal besimin deklaratës së të dëmtuarit. Gjykata me rastin e marrjes së aktgjykitimit lirues ndaj të akuzuarit, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike po ashtu duke mos ja falur besimin deklaratës së dëshmitarit, i cili në bazë të dëshmisë së tij duke u ndërlidhur me provat e tjera të paraqitura me aktakuzë dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme të Prokurorit nuk qëndrojnë nga se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, prandaj pa të drejtë ankimohet aktgjykimi në këtë pjesë sepse, Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka vlerësuar provat e administruara të propozuara në aktin akuzues dhe ato në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka gjetur se i akuzuari L.K. nuk është argumentuar se, ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës kështu që në mungesë të provave të akuzuarin me të drejtë e ka liruar nga akuza. Andaj gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale seanca në shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave, meqë rast në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar: të dëmtuarin

B.S., dëshmitarët A.D. dhe dr.V.O.. Gjithashtu janë lexuar dhe administruar edhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës si: deklaratat e të dyshuarit, L.K. e dhënë në stacionin policor të Rahovecit me datë 09.06.2015 dhe procesverballi mbi marrjen në pyetje të të akuzuarit dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 02.09.2015 dhe në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, deklaratën e dëshmitarit A.D., deklaratën e të dyshuarit A.K.1., raportin e QKMF për të dëmtuarin B.S., ekspertiza mjeko-ligjore e dr.N.U. , raporti i Psikiatrisë për të akuzuarin L.K., raporti i Spitalit Rajonal në Prizren për të akuzuarin L.K. si dhe foto- dokumentacioni dhe shkresat e tjera në lëndë. Pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, gjykata e shakllës së parë me të drejtë ka gjetur se nuk është provuar që në veprimet e të akuzuarit L.K. formohen elemente qenësore të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar në mënyr bindse se në kohë dhe vend sikur thuhet në aktakuzë i akuzuari së bashku me të birin e tij A.1. e kishin sulmuar fizikisht të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore. Nga deklaratat e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit B.S., gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar faktin se ditën kritike pasi ka shkaktuar aksident trafiku, automatikisht është ndalur për të shikuar se mos të njëjtit i ka shkaktuar dëme dhe për ti kërkuar falje, por menjëherë i akuzuari me disa persona të tjerë fillimisht e kanë nxjerr nga automjeti me forcë e pastaj e kanë goditur me grushta, ndërsa më agresori ka qenë A.2.. Duke u përgjigjur në pyetjet e të akuzuarit L.K., ka deklaruar se atë e kanë goditur 3 apo 4 persona, por nuk e dinë se kush e ka goditur me emra, përveç A.2.( djalit të akuzuarit). Gjithashtu ka thënë se e ka goditur edhe A.1. por nuk e di se cilat lëndime ja ka shkaktuar ai e cilat L. pasi që e ka goditur edhe A.2.. Më tej ka sqaruar se kur ka shkuar në QKMF i ka treguar mjekut se ka pasur lëndime në faqen e majtë të fytyrës por i ka treguar se edhe shenjën në faqen e majtë e ka nga lindja. Në vazhdim ka pohuar se ka pasur lëndime edhe në dorë, pasi që të akuzuarit ja kanë përdredhur dorën, por nuk e mban në mend në cilën dorë dhe kush ja ka përdredhur. E ka pranuar se ka pranuar të pajtohet me L. me arsyetimin që rasti të mos shkoj në gjykatë dhe mos të vazhdoj procedura. Pas analizimit të dëshmisë së dëshmitarit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ia fali besimin dëshmisë së tij për këto arsye: duke pasur parasysh se dëshmitari në këtë rast është edhe i dëmtuari dhe qëllimi i tij ka qenë që ta inkriminoj sa më shumë të akuzuarin, gjatë dhënies së dëshmisë ka qenë kontradiktor me veten, e ka pranuar se është sulmuar nga i akuzuarit dhe dy djemtë e tij, ka pësuar lëndime trupore por nuk e din se cili prej tyre ja ka shkaktuar si dhe ka deklaruar se atë ditë ka pësuar lëndime trupore në pjesë të trupit mirëpo një gjë e tillë nuk është shënuar në raportin e mjekut specialist. Nga deklaratat e dëshmitarit A.D., ka vlerësuar se në ditë kritike ka ndodhur një përleshje në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit L., si dhe djemve të tij, e kjo nuk është kontestuese, por kontestues dhe i paqartë është fakti se kush ia ka shkaktuar lëndimet trupore të dëmtuarit. Andaj edhe dëshmisë së këtij dëshmitari gjykata nuk ia fali besimin duke pas parasysh faktin se dëshmitari ka qenë edhe shok i ngushtë me të dëmtuarin , ka qenë kontradiktor gjatë dhënies së dëshmisë, si dhe nuk ka qenë në gjendje që të tregoj se kush saktësisht ia ka shkaktuar lëndimet trupore të dëmtuarit. Nga deklaratat e dëshmitares dr.V.O. gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i dëmtuari ditën kritike ka pësuar lëndime të lehta trupore, e një gjë e tillë përputhet

edhe me provat tjera. Mirëpo e njëjta nuk ka qenë në gjendje që t'ia sqaroj gjykatës se kush dhe me çka i janë shkaktuar lëndimet trupore të dëmtuarit. Andaj, bazuar në arsyet e sipër cekura gjykata nuk ia fali besimin kësaj dëshmie, vetëm sa i përket faktit se kush ia ka shkaktuar lëndimet trupore të dëmtuarit. Po ashtu nga provat materiale është vërtetuar se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore, por me asnjërën prej tyre nuk është argumentuar se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar, më konkretisht se i njëjti ja ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit. Sipas kolegjit penal të kësaj gjykate, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ja ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit L.K., pasi që e njëjta përputhet në tërësi me provat e tjera, e sidomos me ekspertizën mjeko-ligjore, me të cilën konstatohet se i akuzuari në ditën kritike ka pësuar lëndime të lehta trupore. Një vlerësim të tillë si drejtë dhe të ligjshëm, e vlerëson edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret nuk plotësohen elementet qenësore të veprës penale të lartcekur, pasi që sikurse dëshmitarët e dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe nga provat tjera në lëndë, vërtetohet se nuk është kontestuese se i dëmtuari ka pësuar lëndime por Prokuroria edhe gjatë zhvillimit të procedurës së provave nuk ka arritur që të tregoj para gjykatës se cilat lëndime trupore ja ka shkaktuar i akuzuari, e cila lëndime trupore ja ka shkaktuar i mituri A.K pasi që ndaj këtij të miturit është shqiptuar masa e diversitetit. Po ashtu gjykata në rastin konkret drejt ka aplikuar nenin 3 par. 2 të KPPK-së ku thuhet “se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të Ligjit Penal interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pas vlerësimit të provave materiale, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbahen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar nga ana e prokurorit, vlerësime këto si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr. 66/19, datë 25.02.2019

Zyrtari ligjor  
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit  
Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Biljana Rexhiq